



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.06.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 12, 18 dhe 19 qershor 2019.
2. Përmbyllja e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së 55 deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës (votimi i propozimit, përgatitja dhe përcjellja e raportit seancës plenare).
3. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11195, datë 31.05.2019 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

**Mungojnë:**

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Damian Gjikhuri, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Katrin Treska - Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Edvin Kukunja – Këshilltar i ministrit

Tedi Malaveci - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë

Besmir Kodra - Sekretar i Përgjithshëm

Alban Ruli - Kryetar i Këshillit Drejtues

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjetikës

Lindita Sotiri - Drejtore

Jovan Gjika - Koordinator i projektit (AKUM)

Leonard Miloti - Koordinator i projektit (FSHZH)

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** - Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kemi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Në fillim kemi miratimin e procesverbaleve të datave 12, 18 dhe 19 qershor 2019. Procesverbalet ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike. Ka vërejtje? Nuk ka vërejtje.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Ligjeve për datat 12, 18 dhe 19 qershor 2019.

Pika e dytë e rendit të ditës: siç jeni në dijeni sot kemi përmbylljen e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së 55 deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Kemi raportin e Komisionit të Ligjeve për seancën plenare dhe votimin e këtij raporti, i cili më pas do t'i përcillet seancës plenare për votim. Komisioni ynë në shqyrtimin e kësaj kërkesë është komision përgjegjës. Kemi operuar sipas kalendarit të posaçëm që kemi miratuar në komision për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

Komisioni i Ligjeve për shqyrtimin e kësaj kërkesë caktoi relatorë dy kolegët tanë: zonjën Bushka dhe zotin Shameti. Raportin në emër të relatorëve do ta mbajë kolegu Shameti. Të gjithë e keni përpara raportin e përgatitur nga relatorët. Le të dëgjojmë një prezantim të shkurtër të raportit për kolegët, por edhe për opinionin publik.

Fjala është për zotin Shameti.

**Adnor Shameti** - Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në cilësinë e komisionit përgjegjës, pasi u vu në dijeni nga Kryetari i Kuvendit me shkresën nr. 2502/2 prot, datë 17.06.2019 mbi depozitimin e kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin e Presidentit të Republikës, në zbatim të nenit 112, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u mblodh në datat: 19.06.2019, 24.06.2019 dhe 26.06.2019 për të shqyrtuar kërkesën e deputetëve.

Kërkesa e paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një grup prej 55 deputetësh, sipas përcaktimeve të nenit 90, pika 2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 112 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut nisi shqyrtimin e kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës në mbledhjen

e datës 19.06.2019. Morën pjesë për të prezantuar këtë kërkesë dy prej deputetëve nismëtarë: zoti Taulant Balla dhe zoti Ervin Bushati.

Zoti Balla paraqiti përpara anëtarëve të komisionit rrethanat mbi të cilat bazohet kërkesa e deputetëve, duke argumentuar se akti i nxjerrë nga Presidenti i Republikës vjen në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një republike parlamentare, të funksioneve të Presidentit të parashikuara nga Kushtetuta dhe të funksionimit dhe të ushtrimit të sovranitetit të popullit.

Zoti Balla në përfundim të fjalës së tij kërkoi nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta, duke argumentuar edhe një herë në mënyrë të përmbledhur plotësimin e kushteve të parashikuara nga neni 90, pika 2 i Kushtetutës. Pas pyetjeve dhe diskutimeve të anëtarëve të komisionit lidhur me kërkesën e deputetëve u miratua kalendari i punimeve të komisionit “Për shqyrtimin e kërkesës së deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës”, si dhe u caktuan relatorët përkatës.

Bazuar në nenin 112, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, ku parashikohet : “Në rast se kërkohet nga Presidenti i Republikës për t’u shprehur në Komision, Komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve përkatëse”, kryetari i komisionit zoti Manja, me shkresën nr. prot 2502/3, datë 19.06.2019 vuri në dijeni Presidentin e Republikës, zotin Ilir Meta lidhur me datën e mbledhjes së radhës së komisionit për vijimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës së deputetëve për shkarkimin e Presidentit të Republikës, me qëllim garantimin e të drejtës për t’u dëgjuar në Komision.

Shkresës së Kryetarit të Komisionit të Ligjeve iu përgjigj sekretarja e Përgjithshme e institucionit të Presidencës, me shkresën nr. prot 1956/1, datë 22.06.2019. Në këtë shkresë, që përmban një gjuhë joetike, ironike, fyese, tejet ofenduese dhe aspak të denjë për institucionin që përfaqëson kreun e shtetit ndaj deputetëve, Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut dhe ndaj Kuvendit, nëpërmjet sekretares së Përgjithshme, Presidenti i Republikës dëshmoi qartazi se nuk kishte interes të dëgjohej gjatë shqyrtimit të kërkesës në komision.

Procedura e shqyrtimit të kërkesës së deputetëve për shkarkim e Presidentit të Republikës vijoi në dy mbledhjet e radhës së komisionit, sipas kalendarit të miratuar dhe konkretisht në datat 24.06.2019 dhe 26.06.2019.

Komisioni konstatoi se Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në ushtrim të kompetencave të dhëna nga Kushtetuta, neni 92, germa “gj”, ka nxjerrë dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Në bazë të këtij dekreti është caktuar si datë e mbajtjes së zgjedhjeve data 30 qershor 2019. Në përmbushje të këtij parashikimi, kanë filluar të gjitha procedurat sipas Kodit Zgjedhor për bërjen të mundur të procesit zgjedhor brenda afateve kushtetuese dhe ligjore. Konkretisht tashmë janë ngritur Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor; janë përgatitur dhe shpallur listat e zgjedhësve;

është kryer regjistrimi i partive politike; janë depozituar listat e kandidatëve të partive politike; ka filluar fushata zgjedhore.

Ndërkohë që ka filluar periudha zgjedhore, Presidenti ka nxjerrë dekretin nr. 11199, datë 10.06. 2019 “Për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11. 2018, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”.

Sipas nenit 1 të këtij dekreti, shfuqizohet dekreti nr. 10928/ 2018, duke anuluar kështu datën 30 qershor 2019 si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Arsyet e dhëna nga Presidenti mbi anulimin e datës së zgjedhjeve kanë të bëjnë me: shqetësimin e thellë mbi situatën politike në vend; nevojën për çtensionimin e situatës në vend; vetëdijen se kushtet aktuale nuk do të siguronin dot zgjedhje të lira; bindjen se kjo vendimmarrje, në kushtet aktuale, është mënyra e vetme për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës; argumentin se kjo vendimmarrje mbështetet në kompetencën që i jep neni 92, shkronja “gj” e Kushtetutës, preambula e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 3 e nenit 1, neni 3, pika 2 e nenit 4, neni 15, neni 45, pika 1 e nenit 86, pika 3 e neni 88 dhe neni 93 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organi përgjegjës për organizimin, administrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, nuk e mori në konsideratë për zbatim dekretin e Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore dhe vijoi me procesin zgjedhor, duke arsyetuar se ky akt i Presidentit është absolutisht i pavlefshëm, pasi ka dalë në kapërcim të kompetencave të Presidentit dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë. Sipas nenit 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe ligj. Akti që del në mungesë të kompetencës është nul dhe konsiderohet që nuk ka ekzistuar asnjëherë.

Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin e datës 13. 06. 2019, «Rezolutë mbi aktin e Presidentit të Republikës për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05. 11. 2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, bazuar në përgjegjësinë që i ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 1 të saj, ku shprehimisht thuhet se Shqipëria është Republikë Parlamentare, në respektim të parashikimit kushtetues, se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike, duke mbajtur parasysh rolin dhe kompetencat e Presidentit në republikën parlamentare, mbështeti qëndrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vijimin e procesit zgjedhor, si dhe inkurajoi këtë organ të vijojë të mbrojë pacenueshmërinë e të garantojë vazhdimësinë e procesit zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, nisur si rrjedhojë e zbatimit të Dekretit të Presidentit, nr. 10928, datë 05.11. 2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, akt ky që përbën të vetmin akt të ligjshëm të nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019.

Gjithashtu, me këtë rezolutë, Kuvendi i Shqipërisë u bëri thirrje të gjitha organeve publike që ngarkohen nga ligji me detyra, në kuadër të mbarëvajtjes dhe organizimit të zgjedhjeve vendore të qershorit 2019, ta konsiderojnë si inekzistent aktin e Presidentit, datë 10.06.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05. 11. 2018, si dhe të vijojnë përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës, për të garantuar të drejtën kushtetuese të shtetasve shqiptarë për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në pushtetin vendor.

Duke vlerësuar se me anulimin e datës së zgjedhjeve Presidenti ka kryer një shkelje të rëndë kushtetuese, një grup prej 55 deputetësh ka paraqitur një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 90/ 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 112 të Rregullores së Kuvendit, që normon procedurën që ndjek Kuvendi për shkarkimin e Presidentit. Këta deputetë çmojnë se dekreti i Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve vendore është në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një Republike Parlamentare, të funksioneve të Presidentit të parashikuara nga Kushtetuta, si dhe të funksionimit e të ushtrimit normal të sovranitetit të popullit.

Në arsyetimin e kërkesës së tyre, deputetët nënvizojnë se me aktin e tij, Presidenti ka cenuar rëndë parimin e ushtrimit të sovranitetit nga ana e popullit; ka shkelur Kushtetutën dhe njëkohësisht ka marrë njëkohësisht tagra të sovranit e Kuvendit; është sjellë arbitrarisht me pushtetin si pushtet ekzekutiv i pakufizuar, përkundër natyrës së Republikës Parlamentare; ka shtyrë arbitrarisht datën e zgjedhjeve; ka cenuar parimin e periodicitetit të zgjedhjeve; ka

cenuar parimin e ushtrimit të pushtetit në shtet nga një qeverisje e dalë nga zgjedhje të lira; ka cenuar parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë; ka nxjerrë një akt në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjet; ka cenuar parimin e të drejtës së qytetarëve si sovranë, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Komisioni shqyrtoi bazueshmërinë ligjore të kërkesës së paraqitur dhe çmoi se në aspektin ligjor e procedural, kërkesa është në përputhje me nenin 90, pika 2 të Kushtetutës, si dhe me nenin 112 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni, vlerësoi se nga pikëpamja substanciale, kërkesa e 55 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë për fillimin e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 90, pika 2 të Kushtetutës, për të legjitimuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për të hetuar shkeljen e rëndë të kryer nga Presidenti i Republikës. Pjesë e hetimit duhet të jetë dhe shkresa nr. 1956/1 prot, datë 22.06.2019, e sekretares së Përgjithshme të institucionit të Presidencës.

Në përfundim të mbledhjes së datës 26.06.2019, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, vendosi miratimin e raportit, që do t'i paraqitet Kuvendit, duke propozuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar, sipas parashikimeve të nenit 112, pika 2 e Rregullores së Kuvendit.

Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit për paraqitjen e raportit, zoti Shameti!

Sipas procedurës duhet të vazhdojmë me votimin e raportit, në bazë të nenit 112/2 të Rregullores së Kuvendit.

Ju lutem, zoti Braho, jemi në votim!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk ka vërejtje për raportin.

Ke për të shtuar diçka për raportin?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

**Spartak Braho** – Tashmë, ne jemi vënë në dijeni edhe të një vendimi të Kolegjit Zgjedhor, i cili e ka bërë nul dekretin e Presidentit dhe e ka konsideruar tërësisht të pavlefshëm. Kjo rrethanë duhet të jetë prezente në kërkesë, apo jo?

Së dyti, tek arsyetimi për kërkesën, ku deputetët nënvizojnë: “Presidenti me aktin e tij...” ka përsëritje. Për shembull, pika e parë thotë: “Ka cenuar rëndë parimin e ushtrimit të

sovrانيتit nga populli”, që, pak a shumë, përsëritet edhe në pikën e fundit: “Ka cenuar parimin e zgjedhjes së qytetarëve, si sovran, për t’u zgjedhur nga populli.”

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Përsëritje është.

Te pika 3, thuhet: “Ka shtyrë arbitrarisht datën e zgjedhjeve”. Ai nuk e ka shtyrë datën e zgjedhjeve. Po ta kishte shtyrë, do të kishte caktuar ndonjë datë tjetër. Ai nuk ka caktuar datë. Prandaj, fjalën “shtyrë” mund ta zëvendësojmë me ndonjë fjalë tjetër.

Do të preferoja që në të gjitha këto që parashtrori relatori, të kishte edhe dispozita përkatëse, se çfarë është shkelur nga Kushtetuta. Për shembull: “Ka shkelur Kushtetutën dhe ka marrë njëkohësisht tagrin e sovranit dhe të Kuvendit, në kundërshtim me nenin 92, pika 2 e Kushtetutës.”

Këto kisha.

**Ulsi Manja**– Faleminderit, zoti Braho!

Jam dakord me sugjerimet që bëtë për arsyetimin e kërkesës, që lidhet me përmbajtjen e këtij raporti, por, në fakt, thelbi i votimit, që do të bëjmë në Komisionin e Ligjeve, ka të bëjë me pjesën e sugjerimit që ka raporti për Kuvendin, për të ngritur një komision hetimor parlamentar, për të hetuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë nga Presidenti i Republikës, konkretisht të nenit 90/2 të Kushtetutës, si pjesë e procedurës për shkarkimin e Presidentit të Republikës, në bazë të nenit 112/2 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Jam dakord që në objektin e hetimit të komisionit parlamentar, nëse Kuvendi i Republikës së Shqipërisë do të operojë me ngritjen e këtij komisioni hetimor parlamentar pas paraqitjes së raportit nga Komisioni i Ligjeve, pse jo, të jetë edhe vendimi i Kolegjit Zgjedhor, që e hedh poshtë dekretin e Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve. Është tërësisht në vlerësimin e Komisionit Hetimor Parlamentar dhe do të duhet të jetë pjesë e hetimit të këtij komisioni hetimor. Gjithsesi unë dua të hedh në votim raportin me disa sugjerime dhe përmirësime të paraqitur nga relatori, zoti Shameti, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me teknikën legjislativë apo gjuhën juridike të përdorur për të saktësuar dy apo tri gjëra. Propozimi që kanë relatorët, është që Kuvendi i Shqipërisë të ngrejë një komision hetimor parlamentar për të hetuar shkeljen e rëndë të nenit 92 të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës, si pjesë e procedurës parlamentare për shkarkimin e Presidentit, tashmë e iniciuar me kërkesë të 55 kolegëve deputetë.

Kush është dakord me raportin?



1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Me 13 vota pro dhe 1 kundër miratohet raporti i Komisionit të Ligjeve me propozimin që Kuvendi të ngrrejë një komision hetimor parlamentar për të hetuar shkeljen e rëndë të nenit 92 të Kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës, që ka të bëjë me zhdekretimin e datës së zgjedhjeve të 30 qershorit, për të cilën, tashmë, kemi një vendim të formës së prerë të Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, si pjesë e procedurës për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Këtu e mbyllim këtë pikë të rendit të ditës për të vazhduar me pikën e tretë.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 26.06.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11195, datë 31.05.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

#### **Mungojnë:**

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Damian Gjijnuri, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Katrin Treska - Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë nga Ministria e Drejtësisë

Edvin Kukunja – Këshilltar i Ministrisë të Drejtësisë

Tedi Malaveci - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat

Besmir Kodra - Sekretar i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat

Alban Ruli - Kryetar i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësor Privat

**Ulsi Manja** – Të nderuar kolegë le të vijojmë me shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11195, datë 31.05.2019, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Ne jemi komisioni përgjegjës, ndërsa relatore është zonja Vasilika Hysi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Përmbartimit dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Përfaqësuesit nga Ministria e Drejtësisë të zënë vendet. Zonja Treska, mund të uleni!

Nga Ministria e Drejtësisë kemi ftuar zonjën Katrin Treska, Drejtore e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë.

Zonja Hysi, do t’ju lutesha që, si relatore, të bëni një prezantim të shkurtër të arsyeve se pse Presidenti i Republikës e ka kthyer me dekret në Kuvend rishqyrtimin e ligjit “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”! Më pas do të kalojmë në pyetje, diskutime dhe në fund në votim.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Përfaqësues të medias dhe të publikut,

Në fakt, Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11195, datë 31.05.2019, ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” dhe siç e tha dhe kryetari, komisioni ynë është përgjegjës.

Shumë shkurt do të doja të paraqisja argumentet që ka sjellë Presidenti i Republikës.

Në bazë të Kushtetutës, Presidenti ka të drejtë të rikthejë një ligj për rishqyrtim vetëm një herë dhe dekreti i Presidentit për rishqyrtim e humbet fuqinë nëse kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në këtë dekret Presidenti ka sjellë disa argumente dhe ka përmendur 6 arsye pse ky ligj i miratuar nga Kuvendi duhet të rikthehet për rishqyrtim.

Së pari, në dekretin e tij Presidenti argumenton se ligji i paraqitur për shpallje në tërësinë e tij është një akt ligjor pozitiv në drejtim të zhvillimit të shërbimit përmbartimor privat. Pra, e vlerëson këtë ligj. Nuk duhet të harrojmë se ky ligj është pjesë e paketës së reformës në drejtësi, i cili rregullon një nga profesionet e lira, për të cilën ka pasur një analizë të detajuar nga komisioni i ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi, por edhe në përgjigje të një sërë detyrash që janë lënë në planin e veprimit të hartuar nga komisioni *ad hoc* i reformës në drejtësi. Megjithatë, Presidenti, pavarësisht se bën një vlerësim pozitiv të këtij ligji të miratuar, përmend që në disa pika të 6 neneve të tij ka nevojë të bëhet një

qartësim i formulimit të tyre, të cilat duhet të jenë në harmoni me legjislacionin aktual në fuqi, pasi mënyra sesi mund të jenë formuluar mund të sjellë keqinterpretim ose kuptim të gabuar në praktikë dhe, për pasojë, mund të çojë në cenim të parimeve kushtetuese.

Argumenti i parë lidhet me rolin që ligji i ri u jep përmbauesve gjyqësorë privatë në lidhje me mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim.

Të nderuar kolegë, siç e dini, përbarimi gjyqësor privat krahas detyrave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, do të kryejë edhe disa shërbime dytësore, mes të tjerave edhe mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim. Presidenti i Republikës në arsyetimin e vet mendon që kjo është një mbivendosje e kompetencave, që u janë lënë ndërmjetësuesve nëpërmjet një ligji tjetër dhe, e dyta, ka një anashkalim ose nuk merret parasysh, sikurse shprehet ai, Kodi i Procedurës Civile.

Argumenti i dytë që sjell Presidenti lidhet me mungesën e një mekanizimi të qartë ligjor për të vënë në dukje nevojën reale që të përcaktojnë numrin e përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë privatë në territorin e vendit. Sipas Presidentit, censi, që është përdorur si një nga kriteret objektive të përmendura nga ne dhe fakti që ne përcaktojmë numrin e përmbauesve në raport me banorët rezidentë, është problematik dhe nuk u përgjigjet nevojave dhe realitetit. Madje, në argumentet që sjell Presidenti i Republikës, të dhënat e censit, sipas tij, nuk duhen vlerësuar dhe nuk duhen marrë në konsideratë.

Argumenti i tretë është që ka një mungesë harmonie midis rregullave të përcaktuara për mbikëqyrjen dhe kontrollin që ushtron Ministria e Drejtësisë për shërbimin përbarimor gjyqësor privat dhe Dhoma Kombëtare e Përbarimit dhe, në këtë kuadër, arsyeton që dispozitat, konkretisht nenet 58, 59 dhe 60, duhet të rishikohen, sidomos pika 4 e nenit 59, duke argumentuar që përbarimi gjyqësor privat është një funksion i deleguar dhe kontrolli e mbikëqyrja e tij është detyrë parësore e Ministrisë së Drejtësisë. Pra, kompetenca që i është dhënë Dhomës Kombëtare të Përbarimit për të mbikëqyrur në mënyrë konkrete zbatimin e Kodit të Etikës dhe rregullat që lidhen me përmbushjen e detyrimeve nga përmbauesit privatë, Presidenti i Republikës e ka quajtur si një marrje të kompetencave të ministrit të Drejtësisë.

Argumenti i katërt lidhet me dispozitën kalimtare, ku është sanksionuar që të gjitha licencat e marra më parë qëndrojnë në fuqi për aq kohë sa janë marrë në përputhje me kërkesat e ligjit. Sipas Presidentit, mënyra sesi është formuluar neni 88, pikat 1 dhe 2, mund të krijojë kuptim dhe zbatim të padrejtë të ligjit dhe ka nevojë të riformulohet, sepse mund të shfaqin paqartësi dhe kuptim të gabuar ose të ndryshëm në praktikë.

Argumenti i pestë i Presidentit, që është shumë interesant, është pyetja pse nuk kemi bërë veting për përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe në këtë kuadër argumenton që shërbimi përmbarimor gjyqësor privat është një funksion publik i deleguar dhe, duke qenë i tillë, ka nevojë të kryhet një veting i të gjithë personave që gëzojnë certifikata ose licenca në ushtrimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor privat.

Argumenti i fundit është fakti që Kuvendi i Shqipërisë i ka kushtuar më shumë vëmendje shërbimit përmbarimor gjyqësor privat dhe ka lënë mënjanë shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe, në këtë kuadër, argumenton se është përgjegjësi e qeverisë dhe e Kuvendit të kujdeset për përmirësimin e njëtrajtshëm të të dy shërbimeve.

Të nderuar kolegë, në kuadër të konsultimit publik, Komisioni i Ligjeve nëdatën 12 qershor të vitit 2019 ka marrë një shkresë nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë me numër protokolli 589, ku Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë parashtron argumentet e saj lidhur me dekretin e Presidentit dhe për këtë ka vënë në dijeni Kuvendin e Shqipërisë, institucionin e Presidentit, Ministrinë e Drejtësisë dhe misionin EURALIUS V.

Shumë shkurt dua t'ju njoftoj se Dhoma Kombëtare ka mbledhur Këshillin Drejtues të Dhomës së Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, ku ka analizuar qëndrimin zyrtar të Presidentit të Republikës dhe argumentet që ai ka sjellë dhe i ka parashtruar komisionit tonë të nderuar një sërë argumentesh dhe një analizë të detajuar që hedh poshtë të 6 argumentet, që paraqet Presidenti i Republikës në dokumentin që shoqëron dekretin e tij.

Unë nuk dua të lexoj analizën dhe arsyetimet, sepse secili prej jush i ka përpara, por në mënyrë të përmbledhur, dua të theksoj se në vlerësimin e Dhomës Presidenti i Republikës nuk ka marrë një mendim me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje, që kanë të bëjnë me detyrat e tyre. Sjell në vëmendje të Presidentit të Republikës që, në bazë të nenit 92, germa “h” të Kushtetutës, Presidenti i Republikës ka në kompetencë të kërkojë mendim nga Dhoma dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje, që kanë të bëjnë me detyrat e tyre. Kjo do të ishte një mundësi e mirë për të bërë këtë konsultim dhe për të mos ua lënë argumentimin vetëm këshilltarëve juridikë pranë zyrës së Presidentit.

Të nderuar kolegë, shumë shkurt dua t'ju paraqes argumentet një për një për të 6-ta arsye, ose argumentet, që ka paraqitur Presidenti i Republikës.

Në lidhje me argumentin e parë që në shërbimet dytësore, që ne i kemi njohur, si Shërbimi Përmbarimor Privat, cenohet neni 510 e në vijim i Kodit të Procedurës Civile, ky

argument i paraqitur në dokumentin shoqëruar të Presidentit të Republikës nuk qëndron, sepse Kodi i Procedurës Civile rregullon kompetencat që ka Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor, jo vetëm privat, por edhe ai shtetëror lidhur me vënien ekzekutiv të titujve ekzekutivë. Ajo që kërkon Presidenti që ne ta rishikojmë, për ta qartësuar nga ana juridike, nuk ka të bëjë me ekzekutimin e titujve ekzekutivë, por ka të bëjë me një funksion të ri, pra me veprimtarinë dytësore të përmbartuesve gjyqësorë privatë. Ajo që duhet të kuptojnë mirë këshilltarët e Presidentit të Republikës është, se me këtë ligj ne kemi zgjeruar funksionalitetin dhe rolin e përmbartuesve gjyqësorë privatë. Pra, krahas detyrave që ka në Kodin e Procedurës Civile, u kemi dhënë mundësi për të ofruar asistencë në sistemin e drejtësisë, me qëllim që të lehtësohet shërbimi gjyqësor, të ulen shpenzimet, palët t'i zgjidhin çështjet me mirëkuptim, duke shmangur procedurat e sistemit gjyqësor.

Në këtë kuadër, janë marrë parasysh 3 dokumente të rëndësishme.

Së pari, harmonizimi i këtij ligji me ndryshimet e miratuara në Kodin e Procedurës Civile.

Së dyti, është marrë në konsideratë udhëzimi nr. 11, datë 17 dhjetor 2009, i Komisionit Europian për eficiencën në sistemin e drejtësisë i njohur ndryshe, si CEPEJ-i.

Së treti, Kodi Global për Ekzekutimin e Detyruar.

Ajo çfarë kemi parashikuar në veprimtarinë dytësore, ku u kemi dhënë mundësi përmbartuesve gjyqësorë privatë që të ndërmjetësojnë përmbledhjen e detyrimeve me mirëkuptim, bazohet në pikën 34 të udhëzimit dhe në nenin 21 të Kodit Global për Ekzekutimin e Detyruar. Pra, është një standard dhe Shqipëria nuk ka bërë shpikje, por është një përvojë, që e kanë shumica e vendeve të Bashkimit Europian. Kjo vjen edhe në përputhje me kërkesat që kanë direktivat e Bashkimit Europian.

Në mënyrë të detajuar, të gjitha argumentet janë në raportin, që secili prej jush e ka përpara.

Së dyti, në lidhje me përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbartuesve gjyqësorë privatë. Me aq sa kuptoj, stafi që ka hartuar argumentet për Presidentin e Republikës nuk ka kuptuar që ne e kemi forcuar dhe e kemi shtrirë Shërbimin e Përmbartimor Gjyqësor Privat në terren më shumë nga sa e kanë sjellë propozuesit. Propozuesit kanë thënë: një përmbartues gjyqësor privat për 50 mijë banorë, ne e kemi bërë 1 përmbartues gjyqësor privat për 20 mijë banorë. Pra, 20-mijëshi i jep më shumë mundësi përmbartuesit se 50-mijëshi. Në vend që Presidenti i Republikës ta vlerësonte që kemi rritur numrin e përmbartuesve gjyqësorë privatë në territor, na kritikon dhe na thotë që ky numër mund të cenohet të drejtën për të marrë

shërbime në territor nga publiku. Kjo tregon se ata, që e kanë shkruar, nuk kanë parasysh as thyesat dhe as raportin përpjesëtimor 1 me 50 mijë, me 1 me 20 mijë banorë.

Dua të theksoj se për herë të parë në ligjin “Për noterinë”, sidomos në ligjin “Për avokatinë”, ne kemi përcaktuar me kritere objektive të qartë, si mund të shtrihen të gjitha shërbimet në territor, për të pasur shërbim në të gjithë territorin e vendit. Kriteret janë të mirëpërcaktuara në ligj, nuk i janë lënë në mënyrë subjektive ministrit të Drejtësisë së radhës të vendosë për të shtuar ose për të pakësuar numrin e përmbauesve gjyqësorë privatë. Në përcaktimin e kriterëve mbahet parasysh censusi. Të nderuar kolegë, të gjithë e dimë, që censusi dhe të dhënat e censurit janë të dhëna, që shërbejnë për hartimin e të gjitha politikave të përgjithshme në çdo fushë të jetës në Republikën e Shqipërisë, jo vetëm për numrin e përmbauesve gjyqësorë privatë. Është interesante të thuash që censusi i popullsisë dhe banesave është një proces, që jep të dhëna statike dhe nuk mund të merret në konsideratë. Por si mund të qeveriset në çdo kohë, pavarësisht se kush është në qeveri, të hartohen politika financiare, ekonomike, mjekësore, sociale, shëndetësore, fiskale, pa pasur parasysh të dhënat e censurit?!

Së dyti, censusi organizohet nga një institut që është INSTAT-i, i cili është në mbikëqyrjen e komisionit qendror të censurit dhe censusi bëhet në të gjitha vendet botës, nuk bëhet vetëm në Shqipëri. Prandaj ka të dhëna, ka institute, të cilat ngarkohen për të bërë censusin e popullsisë e të banesave dhe të dhënat e tyre shërbejnë si tregues për të rregulluar të gjithë funksionalitetin e shtetit, të shoqërisë e kështu me radhë.

Nga ana tjetër, argumenti që sjellë Presidenti i Republikës që është kundër termit “rezident” që ne përdorim, duke argumentuar se mund të ketë lëvizje të popullsisë dhe mund të mos ofrohet shërbimi i duhur përmbauesve gjyqësorë privatë në territor të caktuar, nuk qëndron. Fjala “rezident” do të thotë kush banon në territor. Për më tepër, sikurse unë e theksova më sipër, ne e kemi rritur numrin e përmbauesve gjyqësorë privatë, duke e bërë një në njëzetmijë nga një në pesëdhjetëmijë që ishte propozuar.

Gjithashtu, kundërshtimi që i bën termit “nevojë publike”, që ekziston në ligj dhe sipas Presidentit është evaziv, nuk qëndron. Padyshim, ministri i Drejtësisë ka kompetenca, që bazuar në informacione, të dhëna të nevojshme, në të gjithë treguesit, siç është vëllimi i punës së veprimtarisë përmbauese, zhvillimi ekonomik i zonës, veçoritë e territorit, mundësitë e mjeteve të komunikimit, transportit, të rrisë numrin e përmbauesve gjyqësorë privatë. Si mund të thuhet që nevoja publike është evazive dhe nuk përcakton qartë indikatorët, në një kohë që ka edhe një sërë indikatorësh, të cilët unë sapo i lexova? Këta

indikatore janë të sanksionuar në ligj, nuk po i them unë. Në këtë kuadër, edhe ky argument i Presidentit të Republikës nuk qëndron.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, Presidenti i Republikës thotë që kompetencat për të mbikëqyrur, kontrolluar, inspektuar dhe bërë procedimin disiplinor i ka ministri i Drejtësisë. Po, edhe në këtë themi, i ka ministri i Drejtësisë.

Ata që kanë hartuar këtë opinion për Kuvendin e Shqipërisë kanë harruar të lexojnë pikën 18/1 të nenit 6, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Kanë lexuar pjesën e parë të fjalisë së nenit, por nuk kanë lexuar vazhdimin, ku thuhet: “Ministria e Drejtësisë mbikëqyr, kontrollon, inspekton dhe bën procedim disiplinor për profesionin e noterit, përmbaruesit privat dhe ndërmjetësit, administratorin e falimentit dhe profesione të tjera të lidhura me sistemin e drejtësisë, sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm në fushën përkatëse”.

Është e drejtë e parlamentit të përcaktojë në ligjin e posaçëm rregulla të detajuara. Në ligjin nr. 29/2019 ne kemi përcaktuar rregulla të posaçme se çfarë duhet të bëjë Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë. Konkretisht, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë ka të drejtë të mbikëqyrë tri aspekte të rëndësishme: respektimin e Kodit të Etikës, respektimin e standardeve profesionale, përmbushjen e detyrimeve si anëtar i dhomës.

Nuk besoj se të gjitha këto kompetenca uzurpojnë dhe marrin përgjegjësitë që ka ministri i Drejtësisë, sepse, në fund të fundit, është ministri i Drejtësisë, jo dhoma, ai që inicion hetimin disiplinor. Në këtë kuadër, edhe ky argument i sjellë në dekretin e Presidentit të Republikës nuk qëndron.

Për sa i takon argumentit se cenohet parimi i sigurisë juridike, kur thuhet se licencat e dhëna mbeten të vlefshme për sa kohë nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji, edhe ky argument nuk qëndron. Në këtë ligj ne kemi sanksionuar parimin e sigurisë juridike dhe nuk i kemi dhënë ligjit efekte prapavepruese.

Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë për këshilltarët e Presidentit të Republikës. Çfarë do të bëhet me një përmbarues privat, i cili ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë, nuk ka shkollë të mesme, por ka arsimin e lartë dhe licencë dhe nga verifikimi i regjistrimit të përmbaruesve rezulton që nuk ka arsim? Do ta lëmë të jetë përmbarues privat meqenëse e ka fituar këtë të drejtë? Edhe pse është ndaluar, do ta lëmë të vazhdojë profesionin? Kjo bie ndesh me argumentin e pestë të Presidentit të Republikës, ku i thotë Kuvendit pse nuk keni bërë vetingun e përmbaruesve gjyqësorë privatë? Pra, nga një anë



kërkon të bëhet veting, kurse nga ana tjetër thotë pse cenoni ato licenca dhe leje të dhëna për përmbauesit gjyqësorë privatë.

Në këtë kuadër, edhe ky argument bie poshtë, sepse qëllimi i legjislatorit ka qenë të ruajë një balancë midis parimit të sigurisë juridike dhe mbrojtjes së interesave të palëve në një proces përmbauesor, ku ky shërbim duhet ofruar nga njerëz me integritet.

Nga ana tjetër, argumenti i pestë i Presidentit të Republikës, ku ai thekson nevojën e kryerjes së një procesi rivlerësimi kalimtar, të njohur ndryshe në publik si “vetingu”, në fakt, bie ndesh me qëndrimet që ka mbajtur Presidenti i Republikës për vetingun në polici dhe vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ju e dini që i gjithë debati që bëhet sot për reformën në drejtësi është pikërisht goditja që i është bërë ligjit të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, kthimi në parlament me dekret të Presidentit i ligjit “Për vetingun e policisë”. Ndërkohë, tani, në rastin e ligjit “Për përmbauesit gjyqësorë privatë”, argumenton pse nuk ka një veting të përmbauesve gjyqësorë privatë. Por le të kthehemi tek argumentet juridike. Në fakt, në ligj ne e kemi rregulluar shumë mirë krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, rritjen e profesionalizmit të përmbauesve gjyqësorë privatë, ka rregulla të përcaktuara për marrjen e licencës, për formimin fillestar, për trajnimet, për etikën; kriteret që duhet të plotësojnë përmbauesit gjyqësorë privatë...

Në këtë kuadër, të nderuar miq, ky ligj është bashkëkohor. Jo se ne kemi qenë kaq të mençur dhe të zotë për ta bërë vetë këtë ligj, por ky ligj është bërë me asistencën e ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë, të cilët i kemi pasur prezentë gjatë gjithë kohës, edhe Dhoma ka pasur të pranishëm ekspertët më të mirë ndërkombëtarë, madje edhe Dhomën Europiane të Përmbauesve Privatë. Pra, misioni EURALIUS V, deputetët e Kuvendit të Shqipërisë dhe ekspertët ndërkombëtarë, që kanë asistuar në hartimin e këtij projektligji, kanë qenë garanci shumë e mirë për të pasur një ligj bashkëkohor dhe, pa dyshim, që ky ligj bashkëkohor mund të ketë përplasje me ata njerëz, të cilët nuk arrijnë të kuptojnë se nuk mund të vazhdojë Zyra e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë të funksionojë si njëzet vjet më parë, sepse ka ndryshuar konceptimi i reformës në drejtësi dhe ka institucione të reja, të cilat ndërtohen në bazë të standardeve të reja.

E fundit, unë pajtohem me kërkesën që bën Presidenti i Republikës për të pasur një vëmendje edhe ndaj përmbauesit gjyqësor shtetëror.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, e kemi thënë edhe ne.

Në qoftë se ju kujtohet, në relacionin që i ka përcjellë seancës plenare komisioni i ka kërkuar ministres së Drejtësisë të fillojë të rishikojë ligjin që rregullon përmbaruesit shtetërorë, por ju e dini që ka dy ligje të veçanta. Në këtë rast ne flasim për ligjin “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, ndërkohë që ligji “Për përmbarimin gjyqësor shtetëror” është një çështje tjetër, që do të rregullohet në vijimësi, pasi është lënë detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë, kur miratua këtë ligj që shumë shpejt në Kuvend të paraqitet edhe ky projektligj.

Në tërësi, të nderuar kolegë, të gjashta argumentet që ka sjellë Presidenti i Republikës (që shoqërojnë dekretin e tij) nuk qëndrojnë, ndaj do të doja t’ju sugjeroja që t’i propozojmë seancës plenare rrëzimin e dekretit të Presidentit.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, për këtë pikë të rendit të ditës është njoftuar edhe institucioni i Presidencës që të jetë pjesëmarrës në shqyrtimin e dekretit “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26 të vitit 2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat””, por institucioni i Presidencës ka konfirmuar mospjesëmarrjen për arsye të një aktiviteti tjetër të programuar nga ana e Presidencës. Përgjigjen e institucionit të Presidencës e keni në tavolinë.

Po ashtu, përveç zonjës Treska nga Ministria e Drejtësisë, tryezës së komisionit i është bashkuar edhe zoti Malaveci, si kryetar i Dhomës së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Privat.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dua të marr edhe mendimin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me dekretin e Presidentit dhe me relatimin e koleges Hysi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kush do ta marrë fjalën nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Prisni, se do të kalojmë edhe te pyetjet.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, të marrim mendimin e atyre dhe do të kalojmë më pas te pyetjet tuaja!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ta marrim tani mendimin e tyre, se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Zeneli, se është bërë edhe debati për ligjin!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Është bërë!

Tani, të marrim një opinion nga ministria dhe pastaj të kalojmë te pyetjet e kolegëve për relatore dhe ministrinë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

**Adriatik Alimadhi** – Ju lutem, pak!

**Ulsi Manja** – E doni fjalën për procedurë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për çfarë e doni fjalën, zoti Alimadhi?

**Adriatik Alimadhi** – Në qoftë se ju thoni: “Të dëgjojmë dhe të marrim mendimin e Ministrisë së Drejtësisë”, atëherë të gjithë elementin e duhur për ta kaluar këtë procedurë e kemi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, na lejoni të japim mendimin tonë dhe të bëjmë pak debat lidhur me kthimin e ligjit nga Presidenti.

**Ulsi Manja** – Është shumë i qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adriatik Alimadhi** – Ju lutem! Unë kam votuar kundër, por kam diçka për ta debatuar me zonjën Hysi.

**Ulsi Manja** – Por ta marrim edhe mendimin e ministrisë, se mund të jetë për...

**Adriatik Alimadhi** – E kemi të qartë mendimin e ministrisë.

**Ulsi Manja** – Nuk e kemi të qartë. Ku e di ti se çfarë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adriatik Alimadhi** – Unë kam votuar kundër ligjit...

**Ulsi Manja** – Një sekondë tani! Ku e di ti se çfarë mendimi ka Ministria e Drejtësisë?!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adriatik Alimadhi** – Pse na ndërprisni?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zonja Treska, fjala është për ju.

**Katrin Treska** – Faleminderit!

Po shprehim shkurtimisht qëndrimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Duke u nisur nga rëndësia që mbart në vetvete Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor, veçanërisht ai privat dhe kompetencat që ka, Ministria e Drejtësisë e ka ndjekur me vëmendje të gjithë procesin e miratimit të ligjit të ri, madje kemi qenë të pranishëm dhe kemi ndjekur të gjitha seancat e diskutimit në Komisionin e Ligjeve për shqyrtimin e dispozitave të ligjit të ri, i cili u miratua me asistencës e misionit EURALIUS V.

Projektligji në fazën e diskutimeve (të gjithë kemi qenë bashkë këtu) ka pasur goxha kundërshtime, komente dhe debate si nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, ashtu edhe nga ana e Dhomës Kombëtare, deri në dakordësimin e draftit, që u miratua nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Kuvendi me ekspertizën e misionit EURALIUS.

Ministria e Drejtësisë i vlerësoi me vëmendje të pesta çështjet kryesore dhe dokumentin arsyetues, që shoqëron dekretin e Presidentit, dhe qëndrimi ynë është: argumentet e ngritura në këtë dekret nuk qëndrojnë, pasi komentet për dispozitat specifike në dokumentin arsyetues janë bërë pa marrë në konsideratë tërësinë e tekstit të ligjit nr. 26 të vitit 2019, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ligji i ri saktëson rolin e përmbarruesit gjyqësor privat, detyrat dhe përgjegjësitë. Gjithashtu, përcakton kriteret të qarta dhe të forta mbi bazë përvojë e meritokracie për hyrjen në profesion, si dhe përcakton qartë rolin kontrollues e monitorues të Ministrisë së Drejtësisë, me fokus shërbimin ndaj qytetarëve. Nëse doni të ndalem në argumente specifike, jam dakord.

Dua të bëj edhe një koment të fundit për çështjen e numrit të përmbarruesve gjyqësorë privatë që ngrihet në dekret. Dua të sjell në vëmendjen tuaj se Ministria e Drejtësisë i ka të gjitha mjetet për të vlerësuar nevojën e marrjes së shërbimit në të gjithë territorin e republikës, sepse ka në varësi edhe shërbimin përmbarrimor gjyqësor shtetëror, i cili është anashkaluar tërësisht në dokumentin arsyetues që shoqëron dekretin.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Treska!

Zoti Malaveci, edhe pse materiali që keni sjellë me shkrim është shterues, meqenëse jeni sot në komision, ju lutem, na flisni shumë shkurt në lidhje me dekretin e Presidentit, i cili kërkon kthimin për rishqyrtim të ligjit “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”.

**Tedi Malaveci** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne si Dhomë jemi njohur dhe kemi sjellë edhe materialin arsyetues në lidhje me konsideratat tona dhe me arsyen që duhet të gjeni ju si komision dhe si Kuvend për të rimiruar ligjin nr. 26 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Materialin që shoqëron dekretin e Presidentit ne e kemi cilësuar si një akt këshillimi tipik antiligjor, konceptuar, servitur dhe shkruar nga këshilltarë ligjorë, në konsideratat tona, të paaftë, të cilët mbulojnë departamentin për çështjet ligjore në Presidencë.

Gjithashtu, konstatojmë se edhe sot pas një muaji dekreti me nr. 11195 dhe arsyetimi i dekretit nuk janë pasqyruar dhe publikuar në faqen zyrtare të Presidencës. Kjo do të thotë shumë, sepse është i vetmi dekret me material arsyetues, i cili ka rreth 18 faqe, që nuk publikohet në faqen zyrtare për t’u parë nga publiku, mediat dhe juristët, në mënyrë që edhe ata të japin vlerësimet e tyre.

Ne nuk mund të fajësojmë Presidentin për arsyetimet e çala që shoqërojnë dekretin e tij, por i bëjmë thirrje të ketë kujdes në zgjedhjen e këshilltarëve ligjorë, duke aplikuar standarde rigoroze të përzgjedhjes dhe rekrutimit të tyre, duke i zgjedhur në lartësinë e detyrës së kreut të shtetit dhe duke konsideruar komponentin e kualifikimit akademik, sepse nuk është e thjeshtë të këshillosh kreun e shtetit në lidhje me profesionet e lira dhe për ligje që vijnë nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke marrë shkas nga propozimi i Presidentit për vetingun e trupës së përmbartuesve gjyqësorë privatë, sugjerojmë, ashtu siç e kemi shkruar materialin që kemi dërguar: së pari, Kuvendi të propozojë një mekanizëm ligjor ku këshilltarët e Presidentit, por edhe të ministrave apo titullarëve të institucioneve më të rëndësishëm dhe të veçantë të shtetit t’i nënshtrohen paraprakisht, përpara marrjes së detyrave këshilluese, vetingut profesional, por edhe atij moral, sepse po shikojmë se këshillimi është një profesion shumë i vështirë. Nuk po i futem në detaje arsyetimit pasi profesoreshë Vasilika e trajtoi në detaje.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Malavec!

Kalojmë te pyetjet dhe pastaj në diskutime.

Fjalën e ka zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi** – Zoti kryetar, unë mendoj se në fillim ne duhet të shprehim problemet, pyetjet apo çfarë kemi, pastaj Ministria e Drejtësisë dhe shërbimi përmbartimor privat mund të na japin informacion. Kështu më duket sikur e trajtoni në mënyrë të njëanshme të gjithë procesin dhe mbledhjen e komisionit. Pra, në fillim duhet të na jepni ne të drejtën e fjalës, sepse, në fund të fundit, ju i keni votat dhe ne japim vetëm mendime, të cilat i shërbejnë apo jo publikut, është një gjë tjetër.

Kam një pyetje për Ministrinë e Drejtësisë, shërbimi përbarimor privat a është krijuar në vitin 2009?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, është krijuar si mundësi alternative për të zbatuar vendimet gjyqësore që kishin prapambetje, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

A keni statistika se si ka avancuar zbatimi i vendimeve gjyqësore? A është më mirë me shërbimin përbarimor privat, apo kur ishte shërbimi përbarimor shtetëror? E para.

Pyetjen e dytë e kam për Dhomën Kombëtare të Shërbimit Përbarimor, Presidenti me të drejtë e kthen ligjin, sepse e gjithë varësia është te Ministria e Drejtësisë, a keni ju statistika për vendimet gjyqësore që i çoni në institucione dhe a keni pengesë nga Ministria e Drejtësisë, sepse për shumicën e vendimeve, nga eksperiencia e them, përbaruesit kanë probleme në zbatimin e vendimit. Përse? Sepse këtë kompetencë e ushtron ministri i Drejtësisë, prandaj themi është në varësi të ekzekutivit. Pra, nëse ministri i Drejtësisë do që të mos zbatojë një vendim në institucione të ndryshme, ai nuk realizohet. Kjo është e qartë. A keni ju statistika, sepse ka mijëra vendime, që i sjellin vërdallë nëpër institucione, dhe nuk zbatohen për shkak se mbikëqyrjen e nenit 58 e ka ministri.

Tjetra, që unë kam kërkuar, ka të bëjë me heqjen ose pezullimin e licencës. Për aq kohë sa përbaruesi gjyqësor të zbatojë vendimet gjyqësore, vendimi apo akti i nxjerrë nga ministri, të shkojë te gjyqësori. Kjo është liria. Jo, i do qejfi ministrit, e pezullon, i do qejfi ministrit, i heq licencën. Në këtë rast kemi kapje të sistemit të shërbimit përbarimor privat në drejtim të ekzekutivit. Kjo është e gjitha.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Zoti Fino ka kërkuar fjalën për procedurë.

**Bashkim Fino** – Zoti kryetar, do të flas për procedurë për të ndihmuar kolegët deputetë, që të orientohemi drejt në një mbledhje komisioni.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Bashkim Fino** – Ne kemi miratuar një ligj, të cilin Presidenti i Republikës e ka kthyer, duke ngritur edhe pesë arsye për kthimin.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

E ka fjalën zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Po flas për procedurë, që të ndihmojmë njëri-tjetrin.

Jam plotësisht dakord me parafolësin. Pyetjet janë shumë me vend, shumë interesante, por kam përshtypjen se kështu kanë qenë edhe kur është diskutuar në themel projektligji për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat. Ne sot jemi në një proces kur Presidenti i Republikës thotë: “Ky ligj, që ju, zotërinj deputet, që jeni nën shantazhe, keni miratuar...”, siç tha edhe dje në konferencë shtypi për kolegjin apo të tjerët, sepse edhe ne mund të jemi në shantazh...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Kryetar, po dëgjoni apo jo? Sepse kjo është më e bukura.

Presidenti thotë: “Unë ju jap pesë argumente pse duhet ta ktheni, ta rregulloni”. Relatori dhe Dhoma e Përmbartuesit Gjyqësor Privat kanë bërë një material shterues, të cilin e lexova me vëmendje, se pse këto pesë argumente nuk qëndrojnë. Ne sot po diskutojmë nëse do të marrim në konsideratë ndonjë nga pesë çështjet pse Presidenti po e kthen projektligjin. Nëse do t’i marrim, le t’i votojmë. Nëse nuk do t’i marrim, sipas relatores, kryetarit të Dhomës dhe ministrit të Drejtësisë, atëherë të themi: “jemi dakord me ta” dhe të votojmë për të rrëzuar dekretin. Nëse ne, zoti kryetar, do të fillojmë të bëjmë diskutime dhe pyetje...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti kryetar, po flas për procedurë dhe për t’ju orientuar ju.

Sipas Rregullores, nëse ne do të vazhdojmë me diskutime dhe pyetje për themelin e ligjit, siç kemi bërë para disa muajve, bëjmë gabim. Ne sot duhet të diskutojmë materialin që ka kthyer Presidenti. Pra, të marrim në konsideratë 1, 2, 3, 4 variantet ose t’i rrëzojmë, duke i diskutuar dhe duke i votuar.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Zoti kryetar, mund ta orientoni mbledhjen, që ta mbarojmë?

**Ulsi Manja** – Ju lutem, të mbarojë fjalën zoti Fino!

**Bashkim Fino** – A mund ta orientoni mbledhjen brenda kornizës ligjore dhe Rregullores? Nëse ka vërejtje për pesë çështjet që ka ngritur Presidenti, t’i votojmë ose t’i rrëzojmë, sepse nuk ka arsye të kthehemi në diskutimin e projektligjit. Pyetjet që bëri kolegu janë të drejta, por ishin për 3 muaj më parë, jo për këtë seancë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Në vazhdim të zbatimit të Rregullores së Kuvendit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zoti Zeneli ka një pyetje.

Më pas do të vazhdojmë me zbatimin e Rregullores.

**Alban Zeneli** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ka një pyetje për zotin Malaveci.

Unë ju dëgjova me kujdes. Ne si deputetë, por sidomos ne, deputetët e opozitës, së pari, jemi për të mbrojtur interesat e Dhomës suaj, në rastin konkret. Me sa dëgjova, ju jeni dakord me projektligjin e miratuar para kësaj mbledhjeje, që ka shkuar te Presidenti dhe me relatoren, zonjën Vasilika Hysi. Domethënë, ju jeni dakord për projektligjin?

**Ulsi Manja** – Po, zoti Malaveci, edhe një herë. Pyetja ishte: jeni për rrëzimin apo për pranimin e dekretit?

**Tedi Malaveci** - Jemi për rrëzimin e dekretit dhe për rimiratimin e ligjit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Të nderuar kolegë, duke u bashkuar plotësisht me sugjerimin e kolegut Fino, relatorja, zonja Hysi, propozoi rrëzimin e dekretit nr. 11195, datë 31.05.2019 të Presidentit të Republikës “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”. Ministria e Drejtësisë ishte dakord me relatoren për rrëzimin e dekretit, edhe Dhoma po ashtu u shpreh me shkrim, por edhe me praninë e përfaqësuesve të saj në sallë për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës. Diskutimi në lidhje me përmbajtjen e këtij projektligji është zhvilluar dhe sot kemi thjesht një objekt për shqyrtimin e kësaj kërkesë: a do ta pranojmë ose jo dekretin e Presidentit? Relatorja, Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma janë për rrëzimin e dekretit të Presidentit.

Kush është dakord për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11195, datë 31.05.2019 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 11195, datë 31.05.2019 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk ka shpjegim vote kur je pro.

Kjo është një procedurë që zonja Hysi do të duhet ta marrë në konsideratë në ndryshimet që do t’i bëhen rregullores.

Zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi** – Unë jam dakord me zotin Fino për të na sqaruar disa procedura, sepse ne jemi deputetë të rinj dhe disa procedura nuk i njohim.



Dua t'ju them diçka, pasi mënyra se si ju po e drejtoni komisionin më duket shumë e shpejtuar. Në qoftë se ju vendosni veton, jua kam thënë edhe dy herë të tjera...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Në rregull për procedurë.

Ju më dhatë të drejtën për të bërë dy pyetje, njëren për përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe tjetrën për përfaqësuesit e Shërbimit Përmbarimor Privat.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë e kam në interes të publikut...

**Bashkim Fino** – Po pse ne nuk e kemi në interes të publikut...

**Adriatik Alimadhi** – Jo, nuk e keni, sepse nga momenti...

*(Diskutime pa mikrofon)*

E ke ushtruar ndonjëherë ti?

**Bashkim Fino** – Cilën nuk kam ushtruar?

**Adriatik Alimadhi** – Ja pra këtë ligj, punën...

**Bashkim Fino** – President nuk kam qenë ndonjëherë, por shpresoj të bëhem, shumë shpejt...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Alimadhi, të lutem!

*(Diskutime pa mikrofon)*

Nuk kam se çfarë përgjigje t'ju jap se diskutimi i këtij projektligji ka mbaruar.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës...

**Adriatik Alimadhi** – Ju lutem, dua një përgjigje!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, pak qetësi!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 26.06.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

**Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Bashkim Fino, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia, Edlira Bode dhe Adelina Rista.

**Mungojnë:**

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Damian Gjikhuri, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Hantin Bonati - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjetikës

Lindita Sotiri - Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Jovan Gjika - Koordinator i Projektit (AKUM) në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

Leonard Miloti - Koordinator i Projektit (FSHZH) në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjetikës

**Ulsi Manja** - Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relator i këtij projektligji është kolegu Edmond Leka. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës zoti Hantin Bonati, zëvendësministër.

Zoti Bonati, mirë se erdhët në komision!

Ju lutem, të na bëni shkurtimisht prezantimin e projektligjit dhe më pas do t’ia kaloj fjalën relatorit, zotit Leka. Më pas do të kemi pyetje, diskutime dhe në fund votimin.

Para se t’ia kaloj fjalën zotit Bonati, kolegja Hysi më konfirmon që prezenca juaj në komision korrespondon edhe me një përvjetor tuajin. Ju urojmë edhe 100 vjeç me jetë dhe shëndet!

Fjala për ju.

**Hantin Bonati** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj të gjithëve për urimet tuaja!

Ky projektligj...

*(Diskutime pa mikrofon)*

...synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2018. Në fokus të tij është zona e bregdetit, zona e jugut të Shqipërisë, e fokusuar në dy pjesë të territorit, në Bashkinë e Himarës dhe zonën e Orikut. Nga ky projekt do të jenë përfitues 80 mijë banorë për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, për këtë do të akordohet një kredi e butë në vlerën 40 milionë euro dhe një grant në vlerën 2 milionë euro.

Situata aktuale në Bashkinë e Himarës dhe zonën e Orikut ka të bëjë me investime të vjetra, që datojnë që nga viti 1964. Kështu që do të synohet për Bashkinë e Himarës furnizimi me ujë 24orë ku do të përfshihen fshatrat: Kuç, Buronjë Pilur, Kudhës, Vuno, Jalë, Livadhe, Himarë fshat, Qeparo, Borsh.

Ndërkohë për zonën e Himarës do të ndërtohet edhe impianti i trajtimit të ujërave të zeza, i cili do të zgjidhë trajtimin e ujërave urbane. Gjithashtu, pjesë e këtij projekti është vënia në punë e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane për zonën e Orikut, sikurse edhe instalimi i të gjitha lidhjeve familjare për qytetin e Orikut. Përfitues për

impiantin e Himarës do të jenë 36 mijë banorë, ndërsa për impiantin e Orikutit 53 mijë banorë, ndërkohë për furnizimin me ujë janë 80 mijë banorë ndër të cilët 50 mijë banorë që janë në zonën e Himarës dhe 30 mijë në zonën e Orikutit.

Aktualisht procesi është në fazën e përfundimit të studimit të fizibilitetit për zonën e Himarës në tetor, ndërsa për Orikutin është projekt dizajni që parashikohet të përfundojë në maj 2020. Fillimi i punimeve parashikohet në shtator të vitit 2020, ndërsa vënia në punë është brenda vitit 2021.

Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm të impiantit të Himarës, do të vihet në punë në vitin 2022 dhe të Orikutit në vitin 2021.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zoti Bonati!

Po, zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit!

Projektligji i propozuar synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar programi sektorial i ujërave në zonën rurale 4. Mua më bëhet qejfi edhe si deputet i asaj zone edhe për faktin se e kam ngritur zërin disa herë në parlament për problematikat e mëdha që ka kjo zonë, sidomos Himara dhe Orikumi, më shumë për ujërat e zeza dhe rrjetin sekondar dhe terciar.

Kjo marrëveshje ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellës-kanalizimeve nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Himarës por edhe vënia në punë e impiantit të ujërave të zeza në Orikum si edhe instalimin e rrjetit sekondar dhe terciar për furnizimin me ujë të pijshëm në Orikum, problematikë shumë e madhe sidomos për këto që janë zona turistike. Himara është propozuar për t'u shqyrtuar më tej, pasi kjo bashki konsiderohet nga rajonet më të rëndësishme turistike të Shqipërisë, po kështu edhe Orikumi.

Zbatimi i këtij projekti do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës për 80 mijë banorët që janë rezidentë në Himarë, për turistët që e preferojnë Himarën për pushimet e tyre, por edhe për 53 mijë banorët e Orikutit dhe turistët.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave njofton qeverinë e Republikës Federale Gjermane se janë përmbushur kushtet, por rëndësi ka që fizibiliteti i kësaj marrëveshjeje është i përfunduar. Në aspektin ligjor dhe procedural është në përputhje me rregulloren dhe Kushtetutën, prandaj ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë.

**Ulsi Manja**- A ka pyetje?

**Bashkim Fino-** Unë kam dy pyetje në lidhje me vizionin që ka ministria. Në relacion thuhet se popullsia totale e Bashkisë së Himarës është 25 mijë e 200 banorë, ndërkohë që numri i turistëve rritet edhe me 20 mijë. Llogaritet që numri i banorëve në Bashkinë Himarë në vitin 2025 të arrijë në 115 mijë. Nëse ne bëjmë një investim 40 milionë, pra marrim kredi nga KfW-ja dhe e bëjmë këtë investim për këta 20 ose 45 mijë banorë, ndërkohë që brenda 5 vjetëve neve do të na rritet popullsia e kryeqytetit 5 herë më shumë, a nuk do të ishte mirë që për vizion një investim t'i paraprinte numrit të popullsisë në raport me atë që do të furnizojmë apo do të rikthehemi prapë pas 3-4 vjetëve të marrim një kredi tjetër për të shtuar kapacitetin e ujit?

Së dyti, dhe kjo është shumë interesante, sepse e shkruani këtu në relacion dhe kjo na bën pis edhe ne këtu pastaj që ngremë dorën. Pra, çfarë thuhet në relacion? Projekti i furnizimit me ujë i zonave rurale 4 do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit. Pyetja që kam është: ministria ka Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës. Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk bën investime, por bën tenderin, ia jep një firme dhe e zbaton. Kur ti ke një drejtori të përgjithshme të ujësjetllës në ministrinë tënde për gjithë Shqipërinë, pse nuk e zbaton ti projektin?

Zoti kryetar, më dëgjo se është shumë interesante kjo, është edhe për zonën tënde!

Ministria ka një Drejtori të Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, e cila mund t'i bëjë vetë të gjitha procedurat, se privati do t'i bëjë prapë, nuk ka pse ia jep Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Jam kundër kësaj dhe votoj totalisht kundër Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Ky fond është krijuar në vitin 1993 për të marrë fonde nga Bashkimi Europian dhe për të investuar në Shqipëri rrugë, kanalizime e me radhë.

Iniciativa juaj është fantastike, që keni në varësi Drejtorinë e Përgjithshme e Ujësjetllës-Knalizimit dhe bravo ju qoftë, e përshëndes këtë dhe mendoj se duhet kaluar, por duhet ta menaxhoni dhe ta aksesoni vetë deri në fund, pa ndihmën e asnjë agjencie jashtë ministrisë suaj.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Bonati.

**Hantın Bonati** – Faleminderit për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë besoj se aty është bërë një lapsus. Studimi i fizibilitetit ka përfunduar dhe është parashikuar deri në vitin 2040 për 50 mijë banorë që do të ketë zona e Himarës bashkë me fshatrat përreth...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

80 mijë është bashkë me Orikumin.

Për sa i përket pyetjes së dytë, është një diskutim që kemi filluar, se për hir të së vërtetës, kjo është një çështje e trashëguar, se agjenci zbatuese ka qenë edhe Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit, kryesisht kjo është vazhdimi i bashkëpunimit të programit me KfW-në, ku zonat rurale kanë qenë të mbuluara nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ndërkohë zonat urbane kanë qenë mbuluar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve.

Jemi duke e trajtuar se si këto të dyja mund të integrohen me të drejtë, duke qenë se agjenci zbatuese është Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bonati!

Ka pyetje të tjera?

**Bashkim Fino** - Nuk e kuptova çfarë donte të thoshte zoti Bonati te pjesa e dytë. Më tha se kisha të drejtë, se janë në diskutime e sipër, se do ta shikojnë dhe t'i lë edhe këtë herë ta kalojnë siç është, apo më tha: “meqenëse është punë fshati, e bën FZHZH-ja dhe, nëse është punë qyteti, do ta bëjë agjencia ime e kanalizimeve?”.

Të lutem, mos na fyeri inteligjencën dhe profesionin që kemi si specialistë dhe deputetë! Në qoftë se bëjmë pyetje konkrete, duam një përgjigje konkrete në sensin se si mund të operojmë. Meqenëse ky nuk dha një përgjigje konkrete “As mish, as peshk”, po ju propozoj, zotërinj deputetë, që të mos e kalojmë këtë nen të relacionit. Ky fond shumë mirë që merr kredi, ne do ta miratojmë këtë kredi, por kjo kredi duhet të jetë funksionale për Agjencinë e Ujësjiellës-Kanalizimeve pranë ministrisë së tyre. Kështu duhet të shprehemi në relacionin tonë si komision. Pastaj nëse këta duan ta bëjnë ndryshe, le ta bëjnë. Kjo është përgjigja më e mirë. Këto përgjigjet as mish, as peshk mua nuk më pëlqejnë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Edhe unë jam dakord që pjesë e raportit që do t'i përcillet komisionit përgjegjës, sepse ne jemi komision për dhënie mendimi, të jetë edhe sugjerimi i kolegut Fino, që ky financim dhe ky projekt të mbikëqyret nga vetë drejtoria përkatëse e Ministrisë së Infrastrukturës, që ka Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve.

E hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi Sektorial i Ujërave”, furnizimi me ujë i zonave rurale 4”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Raporti t’i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për votim.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**